



**“Kur dikush i thotë vëllait të vet: “O qafir (jobesimtar), atëherë njëri prej tyre është meritör për atë epitet. Nëse është siç pretendon, e ka merituar atë, e, nëse jo, atëherë i kthehet vetë atij (thënësit).”**

Ibn Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Kur dikush i thotë vëllait të vet: “O qafir (jobesimtar), atëherë njëri prej tyre është meritör për atë epitet. Nëse është siç pretendon, e ka merituar atë, e, nëse jo, atëherë i kthehet vetë atij (thënësit).”

[Sahih] [Muttefek alejhi]

Profeti ﷺ në këtë hadith paralajmëroi kundër asaj që një musliman t'i thotë vëllait të tij musliman: “O qafir (jobesimtar)!” Me shqiptimin e kësaj fjale të kufrit, njëri prej tyre e meriton atë: nëse i adresuari është ashtu siç u tha, atëherë ajo i bie atij; e nëse nuk është, atëherë akuza për kufër kthehet te ai që e ka thënë.

<https://www.sunnah.global/hadeeth/sq/show/66271>

